

Homes, pasqyra e lajmeve, KIC, 30.07.1998, FDH-29386.

Bexhet (Sylejman) Mazreku

(3.06.1946, shqiptar nga Optrusha/Optëruša, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, katër fëmijë)

Shytrete (Jetullah Hoti)

Mazreku

(7.07.1949, shqiptare nga Samadrazha/Samodraž, komuna e Suharekës/Suva Reka, amvise, katër fëmijë)

Qifti bashkëshortor Bexheti dhe Shyhretja vuanin nga sëmundjet psikike, kështu që për fëmijët e tyre u kujdeseshin vëllai i Shyhretes dhe motrat e Bexhetit. Kur, më **18.08.1998**, forcat serbe e sulmuan fshatin e **Optërušës/Optëruša**, fëmijët e qiftit bashkëshortor Mazreku ishin te motra e Bexhetit në Suharekë/Suva Reka. Bexheti dhe Shyhretja kanë mbetur në shtëpinë e vetë, përderisa të gjithë banorët e tjerë e braktisën fshatin. Pas tërheqjes së forcave serbe nga fshati, familjarët shkuan të shtëpia e Bexhetit dhe Shyhretes, por nuk i gjeten atje. Vetëm diku nga mesi i vitit 2007, Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur i ka njoftuar familjarët se mbetjet mortore të Bexhetit ishin zhvarrosur nga një varrezë në Rahovec/Orahovac, ndërsa ato të Shyhretes nga varreza në Landovicë/Landovica [Prizren]. Për Shyhretën u konstatua se ishte privuar nga jeta me armë zjarri. Mbetjet mortore të qiftit bashkëshortor Mazreku u varrosën në varrezat e Optërušës/Optëruša, më 20.07.2007.

Burimet: deklarata H.H, FDH-33028; OMPE, *Mbetjet...*, FDH-15297; *Serbs Burn Houses that Outlived Shelling in Optëruša, Rahovec*, pasqyra e lajmeve, KIC, 18.09.1998, FDH-29565.

Midin (Sadik) Bytyqi

(10.03.1933, shqiptar nga Brestoci/Brestovac, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, dhjetë fëmijë)

Midini me bashkëshorten Serveten dhe pesë fëmijë jetonin në Brestoc/Brestovac. Së bashku në bashkësi familjare me ta,

jetonin edhe bashkëshortja e parë e Midinit dhe vajza nga martesja e parë. Në mëngjesin e datës **19.08.1998**, Midini dhe i biri Ademi, dymbëdhjetë vjeç, u nisën për në Rahovec/Orahovac, për të rregulluar disa dokumente që Midini i nevojiteshin për pension. Në kthim e sipër nga Rahoveci/Orahovac, në livadhin e quajtur *Babidol/Babin do* [Brestoc/Brestovac], policia ka shtënë mbi ta. Midinin e qëlluan në këmbë. Kur tentoi që me Ademën të kthehej mbrapa për të evituar rrezikun, e qëlluan në kokë. Ademi arriti që të arratisë dhe të shpëtonte. Trupin e pajetë të Midinit e kanë gjetur banorët të Brestocit/Brestovac. E varrosën në varrezat e fshatit. Pas përfundimit të luftës, në muajin qershor të vitit 2000, ekspertët ndërkombëtarë të mjekësisë ligjore i kanë zhvarrosur mbetjet mortore të Midinit. Pas identifikimit, familjarët sërisht i varrosën mbetjet mortore të Midinit në varrezat e fshatit [21.07.2000].

Burimi: deklarata S.B, FDH-15063.

Predrag (Todor) Blagojević

(4.11.1976, serb nga Zoqishta/Zočište, komuna e Rahovecit/Orahovac)

Në muajin gusht të vitit 1998, policia serbe i ka detyruar forcat e UÇK-së që të tërhiqeshin nga **Zoqishta/Zočište**. Pas kësaj, serbët e zhvendosur u kthyen nëpër shtëpitë e veta. Predrag u kthye në fshat nga Hoça e Madhe/Velika Hoça. Një orë pas mesnate, më **20.08.1998**, në qendër të fshatit, Nenadin e ka qëlluar plumbi nga një pushkë snajperi. Ka mbetur i vdekur në vend.

Burimet: *Dnevnik od 19. do 25. avgusta*, Ilustrovana politika, 01.08.1998, FDH-29547; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 106.

Milomir (Momir) Kravac - Mićko

(23.01.1965, serb nga Gjakova/Đakovica, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Milomiri u rrit në fshatin Krushevë të komunës së Plevles [Mali i Zi]. E kishte